



Iniciativa e burrave të rinj

Programi promovon barazinë gjinore, parandalimin e dhunës dhe mënyra të shëndetshme të jetesës






CARE International në Ballkan

CARE International ka përvojë mbi 25 vjeçare në implementimin e programit në rajonin e Ballkanit. Gjatë luftërave dhe konflikteve të viteve të '90-ta, CARE në mbarë Ballkanin i është përgjigjur shkatërrimit, traumës, zhvendosjes dhe urrejtjes ndëretnike me punën e vet humanitare dhe jetë-shpëtuese. Nga viti 2000, CARE është përqendruar në punën zhvillimore dhe qëllimi i vet në Ballkan sot është të sigurohet se të drejtat e shoqërore, ekonomike dhe politike të grupeve të marginalizuara njihen dhe përmbushen, duke kontribuar kështu në paqe të qëndrueshme në rajon. Strategjia e programit të CARE bazohet në dy

shtylla a) Përfshirja socio-ekonomike e komuniteteve dhe grupeve të marginalizuara duke kontribuar në kapacitete më të fuqishme dhe mundësi më të mira për ta, duke i shtyrë të integrohen në shoqëri dhe të kenë qasje në të drejtat e tyre. b) Barazia gjinore e grupeve të marginalizuara, duke promovuar vlerat dhe praktikën e barazisë gjinore, diversitetin dhe praktikën jo të dhunshme, duke fuqizuar kapacitetet e aktorëve për të drejtat e njeriut dhe drejtësinë sociale në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal si dhe duke krijuar mundësi për inovacion, pjesëmarrje, mësim, bashkëpunim dhe avokim. CARE ushqen partneritetin me sektorin lokal të shoqërisë civile dhe qeveritë përkatëse të përkushtuara për të kontribuar për ndryshime pozitive në shoqëri.



Programi Iniciativa e Burrave të Rinj

Projekti Iniciativa e Burrave të Rinj (YMI) ka filluar më 2006 dhe është duke u implementuar në Bosnjë e Hercegovinë, Serbi, Kroaci, Kosovë dhe Shqipëri. Projekti bazohet në kontributin gjithëpërfshirës dhe programatik për të parandaluar dhunën ndërpersonale dhe atë me bazë gjinore si dhe për të promovuar barazinë gjinore në rajon. YMI targeton rininë për të ndërtuar diturinë dhe qëndrimet e tyre në lidhje me barazinë gjinore, praktikën e jetesës së shëndetshme dhe për të zvogëluar nivelet e dhunës së çfarëdo lloji. YMI ka filluar me një hulumtim të vogël kualitativ duke eksploruar qëndrimet dhe sjelljet e burrave të rinj dhe pastaj përgjatë viteve është rritur në një program gjithëpërfshirës me komponente të ndryshme që targetojnë rininë, prindërit, mësuesit/et, Punëtorët/et edukative/ë, studentë/e, gazetarë/e dhe persona të tjerë/a relevant/e.

Që nga fillimi, YMI ka punuar drejtpërdrejt me më shumë se 120,000 të rinj/reja në më shumë se 230 shkolla të mesme dhe më shumë se 1,600 mësues/e të shkollave të mesme, ndërsa në rogramet me kampanja edukative ka përfshirë 750,00 njerëz në Ballkan.

Programet Edukative

Pjesa kyçe e ndërhyrjeve të YMI-t është një seri e punëtorive grupore edukative të shoqëruara me kampanja rreth normave shoqërore që promovojnë një refleksion kritik dhe personal për gjininë, maskulinitetet

dhe shëndetin me një fokus të fuqishëm në parandalimin e dhunës. Punëtoritë kanë qasje pjesëmarrëse dhe adresojnë çështjet e shëndetit dhe lidhjeve nga një perspektivë gjinore, duke përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues, komunikimin dhe negociimin, përdorimin e drogave dhe alkoolit, menaxhimin e zemërimit dhe parandalimin e dhunës.

Një prej qëllimeve kyçe të CARE dhe organizatave partnere është prezantimi i Programit M (i cili punon me burra të rinj) dhe Programi Y (i cili punon me gra të reja dhe burra të rinj) në planprogramet e shkollave të mesme. Deri më tani, programi është akredituar në Kroaci, Serbi dhe Kosovë* nga ministritë përkatëse të arsimit. Më e rëndësishmja, ky program është bërë i detyrueshëm në disa vende të Bosnje dhe Hercegovinës, duke qenë 25% pjesë obligative e orëve të kujdestarëve/eve të klasëve. Në këtë proces, bashkëpunimi i suksesshëm me përfaqësues/e të Ministrisë ka shërbyer për nisjen e trajnimeve me mësues/e ku ata/o kanë pasur rastin të mësojnë për metodologjinë e Programeve M dhe Y dhe gjithashtu kanë rastin të marrin ndihmë teknike nga organizatat partnere rinore për implementimin e programit në shkollat e tyre.

Përpos Programeve M dhe Y, CARE dhe organizatat partnere gjithashtu kanë zhvilluar programe të veçanta edukative, të cilat janë ngritur nga puna me rini dhe nevojat e komuniteteve në Ballkan, e që janë janë si

vijon: Program E – për punën me studentët e shkollave fillore, Program Y Plus – për punën me të rinj dhe reja të rrezikuar nga sjellje radikaliste dhe ekstremiste, Programi D – puna me gra të reja, Program për Ndeshmëri Gjimore në Raportimin e Mediave për Dhunën në Baza Gjimore – puna me përfaqësues/e të mediave. CARE dhe partnerët kanë përshtatur Programin T – programin për baballarë, kujdestarë dhe punëtorë/e shëndetësorë/e e social/e për promovimin e përfshirjes së baballarëve në përkujdesje. Me qëllim për t'iu përgjigjur nevojave emergjente përgjatë krizës së emigrantëve që nga viti 2015, CARE ka zhvilluar Programin Angazhimi i Burrave dhe Djemve në Emergjencë, i cili është i dizajnuar për të punuar me burra të rinj – minorenë të pashoqëruar, të cilët kanë udhëtuar vetëm dhe janë përkohësisht të vendosur në Qendra Pranuese përreth Ballkanit.

Ndërhyrjet e bazuara në shkollë

YMI implementohet në shkollë të mesme, gjë kjo që e lejon atë të arrijë nivele më të larta të pjesëmarrjes ndër burra të rinj dhe gra të reja të moshës 15-18 vjeç. Në shkollat pjesëmarrëse, sesionet e YMI-t udhëhiqen nga facilitues/e të trajnuar/a dhe janë të integruara në orarin e rregullt të orëve përgjatë vitit akademik, me një focus në katër fushat kyçe të programit: (1) qëndrimet gjimore; (2) dhuna; (3) shëndeti seksual dhe riprodhues; (4) përdorimi i drogave dhe alkoolit. YMI gjithashtu zgjerohet edhe përtej klasës. Programi përfshin një tërheqje rezidenciale ku facilituesit/et udhëheqin sesione shtesë dhe aktivitete për ndërtim të ekipit në një ambient më të mbyllur. Aspekt tjetër i rëndësishëm i programit është kampanja “Bonu Burrë”, e cila ka për synim të përforcojë mesazhet kyçe të YMI-t dhe të ndikojë ndryshimin në nivel të shkollave dhe përtej. Kampanja mbështetet nga një shumël-

lojshmëri materialesh edukative, media sociale dhe aksione të organizuara dhe realizuara nga nxënës/e anëtarë/e të klubeve “Bonu Burrë”. Në rajonin e Ballkanit, ekzistojnë 33 klube aktive “Bonu Burrë” me 2,600 anëtarë/e aktiv/e.

Intervenimet në komunitet

YMI shpërndan aktivitetin e vet përbrenda dhe jashtë shkollave. Partnerët e YMI-t me burra të rinj dhe gra të reja dizajnojnë aksione të ndryshme në komunitet, shfaqje teatrale, radio dhe televizione “Bonu Burrë”, forume, tryeza të rumbullakëta dhe konferenca me qëllim për të mbledhur të gjithë hisedarët relevantë për të diskutuar rëndësinë e punës me burra të rinj për parandalimin e dhunës dhe promovimin e barazisë gjimore. Çdo vit, partnerët organizojnë konferenca dhe tryeza të rumbullakëta. Forumet Burrat e Vërtetë janë të formuara në të gjitha shtetet dhe përfaqësojnë forumin e VIP (aktorë/e, muzicantë/e, politikanë/e dhe figura të tjera publike) të cilët/at deklarojnë veten si promovues/e të praktikave të padhunshme dhe të cilët/at veprojnë si aleatë/e në promovimin e maskuliniteteve dhe identiteteve burrërore më paqësore.

Një linjë e ndërhyrjeve të YMI-t orientohet në punë me grupe të sportit, studentë/e të pedagogjisë, gazetarë/e dhe praktikisht me të gjitha grupet të cilat në jetën e tyre të përditshme kanë ndikim në rini.

Një nga aksionet më të spikatura të YMI-t që ndërlidhen me komunitetet është zhvillimi dhe realizimi i një shfaqje teatrale të quajtur “Macho Men”, e cila deri më tani është shikuar nga më shumë se 20,000 njerëz nga mbarë rajoni i Ballkanit dhe Evropa dhe shfaqja teatrale për ekstremizmin tek rinia “Si ta spjegoj këtë tek djali im” e shikuar nga 2,000 njerëz.

Kampanjat

Programi YMI (Iniciativa e burrave të rinj) njihet më së shumti prej kampanjës Bonu Burrë, ndërro rregullat. Tematika e përgjithshme e kësaj kampanje është sfidimi i normave të ngurta të maskulinitetit. Nën-tematikat tjera që shoqërojnë tematikën e përgjithshme përfshijnë parandalimin e dhunës kundër grave, parandalimin e dhunës (ose ngacmimit) në mes bashkëmoshatarëve/eve dhe promovimin e shëndetit seksual dhe lidhjeve të shëndosha, tema të cilat trajtohen edhe përgjatë punëtorive në kuadër të Iniciativës. Karakteri i kampanjës është provokues, e jo predikues. Përdoret një identitet atraktiv vizual me qëllim që të stimulohen burrat e rinj që të mendojnë rreth përfitimeve dhe se sa mirë apo “cool” është që të përfshihen në sjellje dhe stile të padhunshme e të barabarta gjatë jetës.



Kujdessex.net është një web-faqe edukative rreth shëndetit seksual e riprodhues e krijuar me qëllim që të përdoret nga të rinjt/rejat, por edhe nga punonjësit/et e edukimit, të cilët janë të angazhuar rreth kësaj teme. Web-faqja është e dizajnuar nga të rinjt/rejat dhe profesionistët/et dhe po promovohet tek rinia si një web ku ata/ato mund të marrin informata relevante, mund të mësojnë, si dhe të diskutojnë rreth çështjeve që lidhen me shëndetin seksual e riprodhues.

www.kujdessex.net



kujdes se **X**.net

Babai më i
MIRË

Programi Iniciativa e Burrave të rinj është aktiv në përpjekjet botërore për barazi gjinore, duke implementuar **Kampanjën Botërore të Atësisë – MenCare**, e cila promovon përfshirjen e burrave si baballarë dhe kujdestarë të barabartë e të padhunshëm, duke synuar kështu arritjen e barazisë gjinore dhe mirëqenies së familjes. Kampanja MenCare (BurratKujdesen) koordinohet nga Promundo dhe Sonke Gender Justice Network (Rrjeti për drejtësi gjinore Sonke) në bashkëpunim me MenEngage Alliance (Aleanca BurratAngazhohen), në të cilën janë anëtare shumica e organizatave partnere të YMI (Iniciativa e Burrave të rinj). MenCare ka kampanja aktive dhe aktivitete të vazhdueshme në 25 shtete në 5 kontinente.



REAGO
Njerëzishëm

JO ME
DHUNË

Nëse një vajzë thotë JO, unë do të ta përsëris atë
në rast se ju nuk e keni dëgjuar qartë!



powered by
kbb

Gjithashtu, partnerët e YMI janë të angazhuar në realizimin e Kampanjës për Parandalim të Dhunës – **REAGO NJERËZISHËM**, që përqendrohet në kalimtarë/e rasti në çaste të dhunës. Kampanja përfshin aktivitete të ndryshme programatike dhe promovuese, duke angazhuar kështu të rinjt/rejat, por edhe baballarët, trajnerët/et, familjet dhe individët apo grupet tjera relevante në shoqëri.



**Ktheje dijen!
Ndale urrejtjen!**



Kampanja KTHEJE DIJEN, NDALE URREJTJEN

është e fokusuar në parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit në mesin e të rinjve/rejave. Qëllimi kryesor është të promovojë sjelljen sociale në mesin e rinisë që then stereotipet të cilat e stimulojnë qëndrimin ekstremist, duke shpërndarë vlera reale dhe sjellje të mira duke krijuar hapësirë të sigurtë për të rinjt dhe të rejtat.

Kampanja A JE OK?

Është e fokusuar në promovimin e sjelljeve sociale mes të rinjve/rejave në shkollat e mesme. Synon të ndryshojë kulturën, të bëjë shkollën një ambient më suportiv për të rinjt/rejat dhe të inkurajojë ata që të REAGONJË; të kuptojnë kur dikush është në probleme, të inkurajojnë njëri-tjetrin të këshillohen, të inkurajojnë të rinjt/rejat që të kërkojnë ndihmë kur hasin në probleme dhe të tregojnë se ku mund të drejtohen.



Aje OK?

If you notice that someone is not OK

1. Start a conversation
2. Listen without judging
3. Respect that someone has trusted you
4. Provide support as a real friend

For everything else, there is **BMC!**

#ajeOK

care **ALBANIAN GOVERNMENT COMMUNICATIONS** **AK** **Young People Initiative** **smart KOLEKTIV**

Aje OK?

Its OK:

- To ask is someone OK
- To provide support with advices
- To listen without judging
- To nurture trust
- To show a friend that he/she is not alone
- To advise a friend to speak with someone else (professors, psychologists, BMC)

Its not OK:

- ✗ To ignore that your friend has a problem
- ✗ To label others based on...
- ✗ To insult your peers on social media

#AjeOK

care **ALBANIAN GOVERNMENT COMMUNICATIONS** **AK** **Young People Initiative** **smart KOLEKTIV**


YMI në pandeminë COVID-19

Edhe një here në 2020-tën, YMI ka vërtetur se qasja e tij është e qëndrueshme dhe e pështatshme në kontekstin e grupeve target që ka. Pandemia COVID-19 ka pasur ndikim të madh në aktivitetet YMI dhe nuk ka ndaluar aktivitetet, përkundrazi krijoi më shumë hapësirë për inovacion dhe zgjidhje të pështatshme për rininë që pjesëmarrësit/et të kenë prapë hapësirë të sigurtë. Gjatë karantinës totale në Mars deri në Maj 2020, Klubet Bonu Burrë kanë qenë më së shumti aktive me sesione online dhe krijuan qindra mënyra si:

- Punëtoritë e Programit Y online me 3000 studentë të shkollave të mesme
- Evente online me afër 10,000 pjesëmarrës lidhur me barazinë gjinore, parandalimin e dhunës dhe aftësitë e jetës
- Mijëra video që u prodhuan nga KBB-të për rrjete sociale si reagim ndaj trendeve të fundit dhe problemeve të rinisë
- Kampanja online – të fokusuar në parandalimin e dhunës në baza gjinore, parandalimin e

COVID-19 dhe promovimin e jetesës së shëndetshme që përfshinë 20 000 të rinj dhe të reja online;

- Podcasts si KBB podcast, Eggplants in Pajamas, Rinia dhe show live si Chat room për t'u përgjigjur në pyetjet që të rinjt/rejat kanë pasur dhe si reflektim i situates pandemike;
- YMI ka përdorur mënyra të ndryshme për të krijuar kuize, sfida dhe puzzle të cilat janë luajtur nga më shumë se 5 000 të rinj/reja gjatë karantinës;
- Shëndeti mendor ka qenë edhe më i rëndësishëm gjatë karantinës, prandaj YMI ka ofruar mbështetje psikologjike dhe/ose mbështetje të shokëve dhe shoqëve për më shumë se 1 000 të rinj/reja në menaxhimin e emocioneve, frikërave dhe jetës së përdishme.



E Ardhmja për Rininë

Lëvizja “E Ardhmja për Rininë” e Iniciativës së Burave të Rinj synon të sjellë zëra të llojllojshëm të shoqërisë civile, grupeve joformale të qytetarëve, prindër, mësimdhënës/e dhe akterë të tjerë të interesuar rreth të njëjtit qëllim – për të adresuar dhe avokuar për parandalimin e dhunës, barazinë gjinore, aftësitë jetësore dhe edukimin shëndetësor në shkolla në të gjithë Ballkanin.

NDRYSHIMI QË NE DUAM TA SHOHIM:

- Programet për Edukimin e Aftësive Jetësore, siç është programi Y duhet të jetë i obligueshëm në kurrikulat mësimore në edukimin formal;
- Platforma “E Ardhmja për Rininë” duhet të bëhet qendër burimi për Edukimin e Aftësive Jetësore dhe të shërbejë si qendër e avokimit për fuqizimin e anëtarëve/eve për të shkëmbyer përvoja dhe për të ndërmarrë veprime kolektive në nivelin lokal, kombëtar dhe rajonal;
- Komunitetet e fuqizuara veprojnë si agentë afatgjatë të ndryshimit për parandalimin e dhunës, barazinë gjinore, aftësitë jetësore dhe edukimin shëndetësor në shkolla;
- Ndryshohen qëndrimet për parandalimin e dhunës, barazinë gjinore, aftësitë jetësore dhe edukimin shëndetësor tek të rinjtë/rejat në Ballkan;

Future 4YouTH

Ne duam të bëjmë partneritet me të gjithë individët, organizatat dhe institucionet me qëllim të mirë, të përkushtuar dhe të një mendjeje, në veçanti të rinjtë/rejat dhe prindërit e tyre, mësimdhënësit/et, edukatorët/et bashkëmoshatarë/e, punëtorët/et sportistë/e dhe punëtorët/et social/e, pedagogët/et, psikologët/et, aktivistët/et dhe anëtarët/et e akademive që kanë të njëjtat vlera dhe një vision, se si të arrihet një shoqëri më e mirë, e drejtë dhe e barabartë për të gjithë/a.

Bashkohu me ne – Nënshkruaj deklaratën në www.youngmeninitiative.net

#HealthEducation

#LifeSkills

#GenderEquality

#ViolencePrevention

Join us! It's time for a change!

Organizatat partnere

Që prej filleve të tij, programi Iniciativa e Burrave të rinj implementohet prej CARE dhe organizatave partnere, respektivisht organizatave joqeveritare rinore nga regjioni. Fillimisht, CARE ofronte ndihmë teknike për organizatat partnere në punën e tyre me burra të rinj, por me kalimin e viteve organizatat partnere kanë fituar njohuri solide dhe përvojë në këtë fushë, duke u bërë kështu agjentë të ndyshimeve dhe të liderëve në këtë fushë. Ata janë shndëruar në Qendra Burimesh në vendet e tyre, si dhe tanimë njihen publikisht si aktorët më të rëndësishëm në çështjen e përfshirjes së burrave dhe djemve në parandalimin e dhunës dhe promovimin e barazisë gjinore. Partnerët e CARE janë si vijon: Status M Zagreb, Center E8 në Beograd, SIT – Center for Counseling and Research dhe YMCA në Prishtinë, Asociacioni XY në

Sarajevë, Instituti Perpetuum Mobile në Banja Llukë, Fuqia e Rinisë (Youth Power) në Mostar, Sinergjia (Synergy) në Mitrovicën e Veriut dhe Vepro për Shoqërinë (Act for Society) në Tiranë.

Smart Kolektiv, poashtu partner i projektit, është një organizatë jo-fitimprurëse e specializuar në fushën e marketingut shoqëror, me seli në Beograd. Në kuadër të YMI, ata janë ndihmësit kryesor në procesin e zhvillimit të kampanjave. Përdorin qasje pjesëmarrëse, duke përfshirë të rinjt/rejat dhe duke kombinuar mendimet e kreativitetin e profesionistëve/eve të fushës. Kjo metodologji është dëshmuar që ka potencial të prodhojë kampanja jashtëzakonisht të suksesshme, kampanja këto që janë realizuar prej partnerëve të YMI dhe anëtarëve të BMK.

Çmimet/ Shpërblimet

Suksesi i YMI (Iniciativa e Burrave të rinj) është njohur si në rrafsh botëror, ashtu edhe në atë kombëtar, përmes çmimeve si:

- **2010 – Kampanja më e mirë rreth normave shoqërore** – prej Asociacionit Serb për Marrëdhënie me publikun
- **2016 – Vendi i parë me çmimin Ron Koviz në Festivalin Ndërkombëtar të filmit Heroi Im**, për filmin “Post War Machismo: Be a Man” i punuar nga Thompson Reuters Foundation, i cili punoi një dokumentar të shkurtër për anëtarin e KBB nga Banja Luka, Dragan Kisin
- **2017 – Fitues të çmimit të Inovacionit** – nga Rrjeti Botëror i Edukimit në Evropë

Vegëzat:

www.youngmeninitiative.net

<https://program-y.org/>

 FB /youngmeninitiative

 IG / ymiinitiative

 YT: <https://www.youtube.com/channel/UCZNjJpaZP1hMJOGfPZRI9sw>

1

Donatorët:

Në gjashtë vitet e para, Iniciativa e Burrave të Rinj është mbështetur nga Ministria Norvegjeze për punë të jashtme dhe momentalisht, Iniciativa mbështetet prej Austrian Development Co-operation (Bashkëpunimi Austriak për zhvillim), Qeveria e Zvicrës, Oak Foundation dhe CARE Gjermani.

ZYRAT E CARE INTERNATIONAL NË BALLKAN:

Hasana Kaimije #11

71000 Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë

Phone: +387 33 536 790

Aleja Svetog Save 7a #17

78000 Banja Llukë, Bosnjë dhe Hercegovinë

Tel: +387 51 258 200

Email: spetkovic@care.ba,

Žarkovačka #48

11000 Beograd, Serbi

Tel: +381 11 3558 802

Email: mstarcevic@care.rs

Gazmend Zajmi #21

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 224 779; 222 435

Email: care.kosovo@care.org



Mbështetur nga:



Implementuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation

 OAK
FOUNDATION

Partnerët:





www.care-balkan.org

www.youngmeninitiative.net